KUPTIMI I FJALËS SË VJETËR LI

Prof. Dr. Nijazi **GASHI**

PËRMBLEDHJE

Grupi i gjuhëve indoeuropiane fillon me keltishten në Irlandë e shkon gjer në Hind. Duke u nisur nga lindja e duke ardhur në perëndim janë këto gjuhë ose degë gjuhësore indoeuropiane: indishtja, armenishtja, greqishtja, shqipja, gjuhët italike, gjuhët kelte, gjuhët gjermanike, gjuhët baltike e gjuhët sllave. Ka disa gjuhë të vdekura, si hetitishtja në Azi të vogël e tokarishtja në Turkestan. Në Azi të Vogël përveç hetitishtes ka qenë folur edhe frigjishtja, luvishtja e disa të tjera gjuhë indoeuropiane. Në Gadishullin Ballkanik është folur ilirishtja, trakishtja e maqedonishtja. Në Italinë veriore ligurishtja, e ndonjë tjetër.

Fjalë kyçe: *li, ilirishtja, gjuha indoevropiane, gjuhë të vdekura*

HYRJE[1]

Po e nis me thënien e të urtit Platon: "Çdo gjë që nuk e njohim dhe nuk e kuptojmë në gjuhë, mund të jetë barbare, por mund edhe të mos jetë, dhe vetëm të na duket e tillë, për shkak të vjetërsisë."[2] Për hir të respektit personal dhe jo vetëm atij, për sa i takon historisë së gjuhës tonë fillimisht do të shërbehem me njohuritë e ofruara nga Dr. E.Qabej. Njëherit dëshiroj që përmes këtyre njohurive lexuesit t'i ofroj sa më shumë njohuri nga historia e gjuhës në mënyrë që ai vetë të krijoje opinion lidhur me problematikën që do ta trajtoj.

1. KUPTIMI I FJALËS SË VJETËR LI

Grupi i gjuhëve indoeuropiane fillon me keltishten në Irlandë e shkon gjer në Hind. Duke u nisur nga lindja e duke ardhur në perëndim janë këto gjuhë ose degë gjuhësore indoeuropiane: indishtja, armenishtja, greqishtja, shqipja, gjuhët italike, gjuhët kelte, gjuhët gjermanike, gjuhët baltike e gjuhët sllave. Ka disa gjuhë të vdekura, si hetitishtja në Azi të vogël e tokarishtja në Turkestan. Në Azi të Vogël përveç hetitishtes ka qenë folur edhe frigjishtja, luvishtja e disa të tjera gjuhë indoeuropiane. Në Gadishullin Ballkanik është folur ilirishtja, trakishtja e maqedonishtja. Në Italinë veriore ligurishtja, e ndonjë tjetër. Indishtja flitet në një mori dialektesh. Iranishtja përfshinë sot persishten në Persi, afganishten në Afganistan, beluqishten në Beluqistan e osetishten në Kaukaz.Në kohën antike rrokte, përveç persishtes së vjetër edhe avestan, gjuhën e Skitëve e të Sarmatëve e ndonjë tjetër. Edhe armenishtja ndahet në disa dialekte. Greqishtja që në krye të herës paraqitet e ndarë në tri degë kryesore: jonishtja (me atikishten), dorishtja, akeishtja eolishtja. Gjuhët italike përfshijnë dy nëngrupe: latino-faliskishten e oskoumbrishten. Më dysh ndahet edhe keltishtja: gelishtja (me irlandishten në Irlandë e skotishten në Skoci) e britanishtja, ku hyn edhe bretonishtja në Bretagne të Francës; keltishtes i përket dhe gjuha e Galëve të vjetër. Gjuhët gjermanike përfshihen në tri grupe: nordishtja, me islandishten, gjermanishten, gjermanishten e ulët (sot holandisht) e frizonishten;

[1] *Punimin ia kushtoj të madhit dhe të pavdekshmit Aristidh Kola për arsye se duke e lexuar librin e tij "Arvanitasit dhe origjina greke" më motivoi të merrem me këtë çështje.*

[2] *Aristidh P. Kola: " Arvanitasit dhe prejardhja e Grekëve" Tiranë 2002. fq. 211.*

grupi lindor, sot i zhdukur, që përfshinte gjuhët e Gotëve, Vandalëve, Herulëve, Langobardëve etj. Gjuhët baltike janë tri: lituanishtja e letonishtja në republikat sovjetike të Lituanisë e Letonisë, e prusishtja e vjetër që u tret në shek. XVII-te. Më tresh ndahet edhe sllavishtja: grupi jugor me sllovenishten, serbokroatishten, maqedonishten e bullgarishten: grupi perëndimor me polonishten, çekishten, sllovakishten, sorbishten e polabishten, sot e zhdukur; grupi lindor me rusishten (e nënndarjet e saj) e me ukrainishten.[3] Nuk do koment E. Qabej e radhitë gjuhën shqipe në grupin e gjuhëve Indoeuropiane.

Mirëpo ka edhe gjuhëtarë tjerë me renome që gjuhën shqipe e radhisin nëpër grupe tjera të gjuhëve botërore. Për shembull: "Nxënësi i Boppit, August Schleicheri, e përfshiu shqipen brenda Drurit gjenealogjik, me të cilin shtroi teorinë e tij për caktimin e lidhjeve të afërsisë që kanë gjuhët indoeuropiane midis tyre. Brenda kësaj skeme shqipja hyn në degën e gjuhëve indoeuropiane të Europës jugore, ku sipas tij bëjnë pjesë italo-keltishtja dhe greqishtja. Ai e vendon shqipen në afërsi të greqishtes e të latinishtes, po më afër greqishtes. Është viti 1863, kur të dy gjuhët klasike besohej se ishin veçanërisht të afërta me njera-tjetrën, prandaj edhe ai i përmblodhi me emrin "çifti i familjes pellazgjike". [4] Këtë tezë e ndoqi edhe G. Stieri e Dhimitër Kamarda. Një tjetër gjuhëtar me renome botërore Gustav Mejer e vendos gjuhën shqipe në rrethin e gjuhëve indogjermane e kështu me radhë.

Megjithatë E. Qabej në librin e tij "Studime Gjuhësore" kapitulli i V-të shkruan: "Në formimin gjuhësor të shqipes, ashtu si dhe në atë të gjuhëve simotra, përveç lëndës indoeuropiane që përbën bazën vihet re dhe një komponentë, sado e pakët, jo-indoeuropiane. Në gjuhën shqipe kjo është mbeturina e një substrati etnik e gjuhësor që gjetën të parët e Shqiptarëve në viset ku ata zunë vend."[5] Ky konstatim është i pa qëndrueshëm në aspektin e shkencës së Historisë, mirëpo ne nuk do të merremi më këtë çështje sepse nuk është në kuadër të temës që po e shtjellojmë. Në vazhdim autori thotë: "Popujt indoeuropianë, është e ditur, nuk i gjetën te zbrazëta trevat ku u vendosen përfundimisht në agun e historisë. (Mirëpo nuk na ofrohet kurrfarë shpjegimi mbi fatin e asaj popullsie të cilën e gjetën në këto troje e qe ne fakt ishin të parët e Shqiptarëve.- Komenti ynë) Një diçka e ngjashme ka ndodhur në Indi, ku edhe sot e kësaj dite krahas Indaseve është ruajtur popullsia paraindoeuropiane Munda e Dravida. Edhe armenët gjetën në Armeni një popullsi me aq sa dihet, e burimit kaukazik, dhe Hetitët e Frigasit indoevropianë ndeshën në Azi të Vogël në popujt anatolikë."[6] "Më 1854 Hahni, dijetari që shikohet me të drejtë si ati i albanistikës, tezën e tij rreth burimit ilir të Shqiptarëvet e të shqipes e zgjeroi me anën e një vështrimi edhe të situatës etnografike të Ballkanit të vjetër. Në lidhje me këtë, ai në kryeveprën e tij Albanisische Studien, formuloi këto teza: 1) Epirotët e Maqedonët edhe në kohë të Strabonit ishin jo-grekë, ose barbarë; 2) Epirotët, Maqedonët e Ilirët janë farefis në mes tyre; 3) Ka shumë shenja që Epirotët e Maqedonët përbënin thelbin e fisit tireno-pellazgjik, skajet e më tutjeshme të së cilit në Itali e në Traki hyjnë brenda në histori; 4) Ilirishtja është gjuhë pellazgjike në një kuptim më të gjërë.

[3] *Dr. Eqrem Çabej: " Studime Gjuhësore" Prishtinë 1976. fq.11.*
[4] *Dr. Eqrem Çabej: " Studime Gjuhësore" Prishtinë 1976. fq.13.*
[5] *Dr. Eqrem Çabej: " Studime Gjuhësore" Prishtinë 1976. fq.41.*
[6] *Dr. Eqrem Çabej: " Studime Gjuhësore" Prishtinë 1976. fq.42.*

Me këto teza Hahni tek Ilirët si të parët e Shqiptarëve përfshinë edhe Epirotët e Maqedonët, e të gjithë këta bashke e kane prejardhjen prej Pellazgëve. Teoria e tij si tërësi, me gjendjen e sotme të kërkimeve arkeologjike e gjuhësore, në disa anë del e drejtë, ndersa në disa përgjithësime që i bën nuk mund të qëndrojë, po në instance të fundit e tera kjo përmban një thelb pjellor deri të vërtetë. Teza e tij që Epirotët e Maqedonët nuk ishin Grekë, vërtetohet prej dëshmive të vete autorëve Helene, dhe vetëm një dije joobjektive a shovene mund të vazhdoje të qëndrojë në pikëpamje te përkundërt. Teza e afrisë së Epirotëve, Maqedonëve e Ilirëve në mes tyre, është sot një mendim i pranuar pothuajse gjithkund, sepse ato të pakta dëshmi që kanë mbetur nga gjuhët e këtyre popujve flasin qartë për një të tillë afri."[7] Sa i përket prejardhjes së gjuhës shqipe, do të citoj edhe autorë tjerë të cilët shprehin bindje dhe mendime të kundërta me sa u tha më lartë. Për shembull: Mathjeu Aref në librin e tij "Shqipëria odiseja e pabesueshme e një populli parahelen" shkruan: "Gjuha shqipe është mbiquajtur gjuhë indo-europiane, ndërkohë që ajo rrjedh nga pellazgjishtja e lashtë, gjuhë parahelene madje para indo-europiane.

Ajo është një gjuhë e mirëfilltë europiane,... Pellazgjishtja e lashtë dhe etruskishtja kanë ndihmuar në formimin e gjuhëve greke dhe latine. Shqipja përbën një degë të vetme dhe krejt më vete në tërësinë e gjuhëve të folura qysh në kohë të hershme në Europë. Në zanafillë kjo gjuhë ngjitet tek ajo e përdorur nga thrako-ilirët, pasardhës të drejtpërdrejtë të pellazgëve. Ajo në të vërtetë ka mbetur e paprekur që nga koha e pushtimit romak të territoreve ilire në vitin – 168 para Krishtit, sepse duke filluar nga kjo kohe, pjesa më e madhe e ilirëve u strehua në malet e tyre të pamposhtura, duke ruajtur kështu fondin gjuhësor të pellazgjishtes së lashtë. Pjesa më e madhe e gjuhëtarëve (ata që nuk e njohin) e trajtojnë ende si një gjuhë të zhdukur! Ekzistenca e toponimeve të shumta, të përhapura nga Pirenejtë deri në Kaukaz, shpjegohet me lehtësi falë gjuhës së sotme shqipe dhe moria e antroponimeve, eponimeve, oronimeve, etnonimeve që gjenden në mitologjinë e mbiquajtur greke, të cilat gjuha shqipe arrin t'i deshifrojë me lehtësi, vërtetojnë të qenët nga një trung të pellazgjishtes së lashtë dhe gjuhës shqipe."[8] Kurse R. d'Angely në librin e tijë "Enigma" shkruan: "Që nga shfaqja e njeriut mbi globin tone ka nisur formimi i gjuhës primitive lidhur me secilën race. Kështu për racën e bardhë u bë formimi i pellazgjishtes primitive, nga e cila më pas kanë dale gjithë gjuhët e tjera dytësore, tretësore, katërsore etj., sipas numrit të përzierjeve, që ka pësuar pellazgjishtja primitive me shtimin e elementëve të huaj: atlantë e mongolikë primitive, dhe në një epokë relativisht të vonë, që nuk i kalon 20.000 vjet më pare duke u nisur nga sot, me shtesat e tjera dytësore: mesopotamase, aramease etj."[9]

Ngjashëm me dy autorët e sipërcituar shprehet edhe S.Riza i cili në librin e N. Vlorës shkruan: " Kështu, sipas Bibles në kohë të hershme *"mbarë toka kishte vetëm një gjuhë dhe fjalët e njëjta".* Këtë të vërtetë e pohon edhe Kur'ani. Cila, pra, ishte kjo gjuhë mbarënjerëzore?! Kjo ishte, natyrisht, gjuha *hyjnore* e profetëve, të cilën e kemi quajtur "*gjuha-nënë*", më saktë kjo gjuhë ishte pellazgjishtja-ilirishtja-shqipja e moçme. Latinishtja, greqishtja, e ashtuquajtura sllavishtja e vjetër dhe osmanishtja ishin gjuhë artificiale, ishin gjuhë administrative të perandorisë romake, bizantine dhe osmane."[10] Edhe autorja e re e talentuar E. Kocaqi e quan gjuhën shqipe çels të

[7] *Dr. Eqrem Çabej: " Studime Gjuhësore" Prishtinë 1976. fq.43-44.*
[8] *Mathieu Aref: " Shqipëria odiseja e pabesueshme e një populli parahelen" Tiranë 2007. fq. 201.*
[9] *Robert d'Angely: " Enigma" Tiranë 1998. fq. 171.*
[10] *Nermin Vlora Falaski: " Pellazgët Ilirët Etruskët Shqiptarët" Prishtinë 2004. fq.19.*

gjuhëve indo-europiane. Sa i takon formimit të gjuhëve në fillet e saj unë do të sjell një thënie të Eduard Shnaider nga libri i tij e ka përmbledhur shumë drejt: "Ne nuk mendojmë që njeriu në kohët e hershme, qysh se ai ka nisur të artikulojë mendimin e tij ka përdorur një frazë, madje një fjalë dyrrokëshe për të emërtuar diellin, qiellin, yjet, token, zjarrin, erën, njeriun, kafshën, zogun, frutin, kokën, ujin, etj.

Të gjithë këta emra duhet të kenë qenë të shkurtër, më shumë të forte se të butë, shprehës dhe që shpreh harmoninë shëmbëllyese, e cila u bë figura e pare e retorikës, të cilën njeriu zanafillor e shpiku vetvetiu".[11] Besoj që mendimet dhe qëndrimet e autorëve të lartshënuar mjaftojnë që lexuesi të krijojë opinion të pavarur gjegjësisht opinion më vete lidhur me prejardhjen e gjuhës shqipe. Në këtë kontest përkrah qëndrimin e Dh. Kamardës, M. Arefit, Skënder Rizës dhe të E. Kocaqit, të cilët thonë që gjuha shqipe rrjedh nga gjuha pellazgjike e cila nuk është gjuhë që bën pjesë në grupin e gjuhëve indo-europiane, por është gjuhë më vete dhe është gjuhë para-indo-europiane. Gjuhë e popullit të cilin e gjetën në troje të veta popujt indo-europiane të cilët erdhën e u vendosen në këto troje. Këtë bindje do të provojë ta mbrojë, duke u shërbyer me disiplinën gjuhësore të fjalëformimit, të cilën në tekstin e Sh. Islamajt: "Gjuha ligjërimi dhe fjala" e gjejmë të formuluar kështu: "Në mënyrë tradicionale, studimi fillon me përkufizimin se fjala mund të jetë e thjeshtë, e prejardhur dhe e përbërë, jepen parashtesat e prapashtesat , si dhe kategoritë e fjalëve ku paraqiten ato më prodhimtare; trajtohet si problem i veçantë edhe në kuadër të kategorive gramatikore (emër, mbiemër, folje, etj.); hollësisht përshkruhen veçoritë morfologjike të fjalëve motive dhe mënyra e arritjes së bazës fjalëformuese; nuk mungojnë as çështjet semantike, por ato vështrohen në plan të dytë; fjalët e prejardhura klasifikohen në mënyrë të përgjithësuar sipas kuptimit, në varësi nga formatet fjalëformuese që marrin pjesë në to; në raste të rralla u kushtohet rendësi rasteve të veçanta, të cilat për çfarëdo arsye shmangen nga rregullsia fjalëformuese e klasës së cilës i takojnë.[12]

Ne, gjate shkollimit, jo një here kemi dëgjuar që fjala *Litos* është fjalë greke që do të thotë *guri, tokë*. Gjykuar sipas Shneider dhe B Islamaj unë mendoj që fjala *Li-tos* është fjalë e thjeshtë pellazgjike dhe shumë e lashte e cila në origjinal duhet të jetë *Li*, por që më vonë grekët ia shtuan prapashtesën *tos* për ta ndryshua si shumë fjalë tjera të gjuhës sonë qe i ndryshuan ngjashëm. Pra, siç unë mendoj, fjala *Li* është fjalë pellazgjike që ka kuptimin *guri* gjegjësisht *shkëmb*. Në aspektin gramatikor definohet si emër, mirëpo duhet theksuar që ajo është fjalë bazë gjegjësisht morfemë nga e cila janë formuar shumë fjalë tjera që do t'i shohim më poshtë. Kjo fjalë shpesh e ndërron rolin dhe nga emër shndërrohet në mbiemër që ka kuptimin i madh, madhështor, i hijshëm, e kështu me radhë. Edhe Louis Benlew, A. Kola, A. Spahiu dhe A. Mati kanë ardhur deri afër identifikimit të kësaj fjale por mendoj nuk ia kanë arritur ta identifikojnë. p.sh. A. Kola në vend që ta identifikoje si *Li* e ka identifikuar si *Lia* kurse A. Spahiu në librin e tij "Pellazgët dhe Ilirët në Greqinë e Vjetër" në kreun IV – Gjuhësia, kur e trajton Akilin vjen shumë afër identifikimit të kësaj fjale dhe deshifrimit te kuptimit të saj.

[11] *Eduard Shnaider: " Pellazgët: një race e harruar " Paris 1894*
[12] *Shefkije Islamaj: Gjuha ligjërimi dhe fjala" Prishtinë 2004. fq. 114*

"Në këto raste F. Baderi mendon se emri i Akilit është i lidhur me atë të akeasëve. Sintagma e përbashkët për akeasit dhe Akilin është *megh2-bher-,* e cila do të thotë *plaçkë që bëjmë.* Kjo sintagmë mund të thotë metaforikisht " lufta që jep plaçkë të madhe" ose "luftëtarët, të cilët e bëjnë këtë luftë janë plaçkaxhinjë të mëdhenj ... Në këtë rast, F. Baderi shikon në emrin Ahilos "një derivat të *megh2-*, hipokoristik të një forme me *-i-lo-*,e cila krahasohet me got. *Mikilis,*... "[13] Pra, siç po shihet A.Spahiu ka hetuar një ngjashmëri të emrit *Akil* me mbiemrin i madh, por megjithatë nuk e godet cakun dhe dështon duke e ofrua fjalën i-lo në vend të fjalës Li. Edhe M. Aref duke provuar të shpjegojë kuptimin e fjalëve peleia, pelia, plakia dhe të emrit Akili vjen shumë afër identifikimit të kësaj fjale, por për fat të keq nuk ia arrin. Më shumë se të gjithë që u përmendën më lartë, kësaj çështjeje i përkushtohet i madhi Louis Beonlew. Ky në librin e tij: "Greqia përpara Grekëve" kësaj problematike ia kushton një temë të tërë:

Fjala LIKOS dhe kuptimet e saj të ndryshme. Likia, Likaonia, Likaon, Pisida, Piza. Emrat e njerëzve, qyteteve, maleve dhe lumenjve, të cilët përmbajnë rrënjën e lasht lux (lik) dhe që janë përhapur në pothuajse të gjithë rajonet e Greqisë. Në Kretë dhe në Azinë e Vogël, na paraqesin një nga problemet më interesante dhe më të vështirë për t'u zgjidhur. Le të përmendim emrat ... (Likos), ... (Likios), ...(Likeon), ...(Oros), ... (Likoa), ... (Likosura), ... (Likaon), ... (Like), ...(Likastos), ... (Likoria), ... (Likarmas)etj. Dihet qysh prej shumë kohësh se këto fjalë nuk shpjegohen mjaftueshëm nga fjala ... (Likos), pra ujku dhe se ndërkohë që grekët pretendonin ta emërtonin me Apollon ... (Likios) perëndinë që shfaroste ujqit ... (Likoktonos theos), u gabuan nga një etimologji e rreme. Dihet se te të lashtët Apolloni ka qenë mbi të gjitha perëndi e dritës; se grekët dikur e quanin dritën *lux*, pikërisht si Latinët..."[14]

Gjate punës se bërë në këtë drejtim kam identifikua shumë emra, dhe fjalë të përbëra që në vetvete përmbajnë morfemën *Li* e cila na çfaqet herë si emër e herë si mbiemër**.** *Li-a* në kuptimin gramatikor është emër që tregon një sëmundje ngjitëse dhe vdekjeprurëse. Gjate evoluimit të gjuhës populli nuk është mjaftuar që këtë sëmundje ta quaje vetëm me emrin *Li-a* edhe pse në esencë edhe si i vetëm ky emër tregon që bëhet fjalë për një sëmundje të madhe dhe të rrezikshme. Pra nuk është mjaftuar vetëm me kaq dhe ia ka shtuar edhe mbiemrin -e madhe. Ky mbiemër e vërteton konstatimin tonë që *Li-a* tregon diçka të madhe, në rastin tone sëmundjen e madhe. *Li-ni***,** është bimë e cila në kohët e lashta kishte rendësi për jetën e njerëzve sepse prej tij bëheshin rrobat të cilat i mbronin nga të ftohtit duke ua mundësuar mbijetesën.

Li-si, është bimë-dru i madh shumëvjeçar me rendësi të madhe për jetën dhe mbijetesën e njerëzve. Në këtë rast ky emër ka disa kuptime. Në aspektin e pamjes ky emër tregon një bimë e cila është e madhe dhe duket si një shkëmb dhe përveç kësaj ka edhe hijeshi duke u dukur madhështor. Pra njerëzimi në fillesat e tij Lisin e ka identifikuar si një bimë të madhe sa një shkëmb, të fortë si shkëmbi, por edhe të hijshëm dhe madhështor. Në besimin e pellazgëve ky dru ishte identifikuar si bimë shumë e rëndësishme sepse shumë herë falë kësaj bime të parët tanë kishin mbijetuar andaj edhe e kishin shpallur si emblemë të faltores në Dodonë. *Li-sa***.** Lisa

[13] *Dr. Arsim Spahiu: " Pellazgët dhe Ilirët në Greqinë e vjetër" Tiranë 2006. fq. 244.*

[14] *Louis Beonlew: Greqia përpara Grekëve" Tiranë 2008.fq.133.*
(Ky punim i ka hiq më pak se dhjetë faqe e gjysmë)

është emër që përbëhet prej fjalëve *Li* dhe fjalës *sa* që ka kuptimin sa e bukur apo sa madhështore e që në mitologjinë pellasgjike tregon perëndeshën e bukurisë. Besoj që çdo koment në këtë rast është i tepërt. *Li (i = y)- ra* (Ly-ra) është instrument muzikor shumë i lashtë i cili nëse zbërthehet përmes kuptimit të fjalës *Li* do të thotë instrument që tingujt e saj janë madhështorë sepse kemi thënë që fjala *Li* do të thotë edhe madhështor, kurse fjala *ra* ka domethënie –bie, që do të thotë instrument që bie në mënyrë madhështore. *Li –ri, (Liria)* ka kuptimin e një gjendje kur njerëzit janë të lirë mirëpo edhe kjo fjalë për bazë ka fjalën -Li që do të thotë -rri n'të madh. Prej këtu del kuptimi i emrit Ilir të cilin shumë gjuhëtarë e historiane e kanë lakuar e lëvruar duke u munduar t'ia japin kuptimin here duke u munduar ta nxjerrin nga emri i një lloj gjarpri –Illyrka, e here nga fjala i lirë, e është provuar të shpjegohet edhe përmes legjendës që qarkullon nëpër Evropë dhe botë ku thuhet që emri Ilir vjen nga emri i të birit të Kadmit dhe Harmonisë. etj. etj. Mirëpo, si po shihet emri -Ilir dhe -Iliri rrjedh nga fjala -*Li* dhe fjala -*rri* që do të thotë njerëz që rrinë n't'madh kurse vendi i tyre quhet Iliri dhe ka dy kuptime, por që të dy kuptimet, përsëri kanë për bazë fjalën-*Li*. Në njërin kuptim mund të shpjegohet si vend i njerëzve që rrinë n't'madh ose i njerëzve krenar ose i njerëzve të mëdhenj sepse dihet që Ilirët ishin të gjatë dhe të zhvilluar kurse kuptimi i dytë mund të shpjegohet si vend malor sepse kemi thënë që fjala-*Li* ka kuptimin shkëmb – mal.

Çfarë koincidence sepse edhe vet fjala Mal për bazë ka fjalën *Li* (Ma-li). Kur jemi te emri *Ilir* nuk mund të shkojmë më tutje pa e përmendur një tradite sipas të cilës fëmijët e Polifemit dhe Galiates " vashës barrdhavele" janë *Iliri, Gali* dhe *Kelti*. Në mënyrë spontane të bie në sy që bazë e të gjithë këtyre emrave është fjala -*Li* e cila varësisht se çfarë kuptimi donë t'i japësh emrit, na paraqitet me parashtesa dhe prapashtesa here si përemër here si mbiemër e here si folje. Vete emri i Polifemit përbëhet nga fjalët: *Po- li- femi* që do të thotë sa fëmi madhështor ose i bukur. Për Ilirin e dhamë shpjegimin me lartë, kurse emri *Kelti* përbëhet prej fjalëve *Ke- Li-ti.* Do me thënë ti ke hijeshi ose je i hijshëm, i bukur. Emri *Gali* përbëhet prej fjalëve *Ga* dhe fjalës *Li* që ka kuptimin fëmija që i ngjan të madhit apo i ngjan në të madhërishëm. *Li-burrni.* Liburrni është emër i një fisi shumë të njohur Ilir. Në këtë rast morfema bazë e emrit është mbiemri burrni që tregon karakterin e një njeri apo të një grup njerëzish e në këtë rast të fisit Liburrni kurse fjala gjegjësisht mbiemri *Li* e përforcon gjegjësisht ka karakter sumues të mbiemrit burrni. Pra emri Liburrni ka domethënie gjegjësisht dominon një fis i cili karakterizohej për burrni të madha ose që për nga karakteri cilësoheshin si burra madhështor. *Ma-li:* Edhe emri Mali për bazë ka fjalën -*Li***.** Mali është një pjesë e ngritur e tokës. Ka edhe pjesë të tjera të tokës që janë të ngritura, por nuk iu thuhet Mali. Atyre iu thuhet Kodër, breg apo disi ndryshe. Kurse mali është me i lartë se të gjitha ngritjet tjera të tokës dhe për këtë arsye i thuhet *Ma-li* që do te thotë -ma i Larti, ma i ngrituri, ma madhështori. Me qëllim që punimi të mos bëhet monoton do t'i zbërthej edhe disa emra shumë të rëndësishëm për shkak të peshës së tyre edhe gjuhësore por edhe historike kurse shumë prej tyre do ti ofroj të shkoqitur që lexuesi të mundet vete t'i deshifroje dhe me ua dhënë kuptimin. *Di-e-lli***.** Edhe emri Dielli ka për mbiemër fjalën *Li* sepse përbëhet prej fjalëve *Di* që ka kuptimin që bënë dritë gjegjësisht që shkëlqen, lidhëses e dhe fjalës **Li** si e thamë më lartë. Pra kuptimi i emrit Dielli është ai që ka shkëlqim gjegjësisht dritë të madhe apo madhështore. *Ka-li***.** Me emrin kali pellazgët emëruan një kafshë që në fillim shërbente vetëm për ti hipur dhe atëherë e quanin Hip, mirëpo më vonë e panë që ishte kafshë e bukur në krahasim me kafshët tjera dhe thanë që ka *Li* që do me thënë ka hijeshi ose që është kafshë madhështore. S'di a ka nevojë për

tjetër koment?! *Herku-li:* Grekët në kontinuitet i adoptuan mitet dhe legjendat tona duke i prezantuar si vlera të tyre kulturore e kombëtare. Këtë po e them se edhe Herkuli në botë vlen për hero me origjinë greke. Mirëpo kjo çështje mund të demantohet shumë lehtë për arsye se Herkuli përpos që për bazë të emrit e ka fjalën *Li* ka jetuar dhe vepruar shumë kohë para çfaqjes së emrit Grek i cili në esencë paraqet një pjesë të popullit tone të përzier me një numër njerëzish nga Libia dhe nga Azia. Tentativa e autorëve grek që edhe përmes Herkulit ta përvetësojnë të kaluarën heroike të Pellazgëve nuk është hera e pare dhe as e fundit.

Mirëpo, në rastin e Herkulit të gjithë dështojnë. Kjo për arsye se nuk mundet që Herkuli edhe t'i ketë pasur armët prej guri, pra të ketë jetuar në epokën e gurit edhe të jetë grekë për arsye se në atë kohë grekët nuk përmendeshin asgjëkundi, ose madje nuk ekzistonin fare. Pastaj harrojnë grekët se përpos pelerinës dhe përkrenares që i kishte mbaruar vete nga lëkura dhe kafka e luanit të cilin e kishte vrare, armët ia kishin bere hyjnitë: Apolloni harkun, Hefesti mburojën, Hermesi shpatën, Poseidoni koçinë. Sigurisht që këto hyjni nuk janë greke këtë e dine të gjithë. *Ylli, Hylli:* Sa për njoftim të përgjithshëm dëshiroj te bej me dije se Ylli është bir i Herkulit dhe i Dhesamirës. Edhe një Gjigand i mbirë nga dheu mbante këtë emër. Në të vërtetë Yllasit ishin Ilirë dhe këta dy emra kanë domethënie shume të ngjashme për mos te thënë të njëjtë. Meqenëse në këtë rast nuk e kemi për qëllim sqarimin e aspektit mitologjik të Yllit po kalojmë në qëllimin e shpjegimit të domethënies së këtij emri e që për bazë ka fjalën *Li*.

Pra, emri Ylli tregon trupat qiellorë (Yjet) dhe përbëhet prej dy fjalëve: Fjalës *Y* që është e njëjtë me fjalën *I* dhe fjalës *Li* që do të thotë është lartë në lartësi, do me thënë rrinë lartë. *Li-keni:* Emri Likeni përbëhet prej fjalëve *Li* dhe fjalës *keni* e që ka kuptimin keni hijeshi. Emri Likeni tregon një vend ku grumbullohet uji. Mirëpo edhe vendet ku bëhet grumbullimi i ujit dallojnë në mes veti andaj vendet e ulëta ku grumbullohet uji quhen moçal kurse Likeni zakonisht ndodhet nëpër vende malore dhe kur shikohen nga ndonjë lartësi më e madhe, me të vërtetë kanë pamje madhështore. *Plisi: P-li-si* është kapela simbol i shqiptarëve dhe i pellazgëve. Emri *Plisi* përbëhet prej fjalëve: *P* që tregon një fjalë pohuese *Po*, fjalës *Li* që tashmë e kemi thënë që do të thotë shkëmb i lartë e në këtë rast edhe i mbuluar me bore – i bardhë dhe fjalës *Si*, që do të thotë: është (P-Po), si shkëmbi i mbuluar me borë. Është madhështor. *Polisi:* Të gjithë mendojnë që fjala *Polisi* është fjalë greke që tregon vendin urban gjegjësisht Qytetin. Kjo është e vërtetë, por domethënia e këtij emri është e përbëre nga fjalët shqipe: *Po* që tregon një pohim, fjalës *Li* që tashmë e kemi thënë disa here domethënien e saj dhe fjalës krahasuese *Si***.** Që ka kuptimin vendbanim me pamje madhështore ose thjeshtë, vendbanim i përmasave të mëdha. *Plaki:* Plakia në kohëra të hershme ishte institucion shumë i rëndësishëm shoqëror që sot quhet Kuvendi i pleqve. Pellazgët llogarisnin që njeriu madhështohej kur plakej andaj i thonin: Po – *li* – a – ki. Do me thënë pohonin që ishte madhështuar dhe për këtë respektohej**.** ***Ilioni:*** Ishte emri i Trojës, qytetit mitik të dardanëve-pellazgëve. Fjala Troje është fjalë shqipe – pellazge, që tregon vendbanim. Mirëpo meqë Troja ishte qytet i madh dardanët krenoheshin me madhështinë e tij andaj e quanin edhe *I – Li – oni* që do me thënë qyteti ynë madhështor.

***Akili*:** Akili është një hero legjendar Akeas gjegjësisht Pellazg i cili bashkë me pellazgët tjerë të Pellazgiotisë ishin sulur për ta rrënuar Trojën – Ilionin për shkak të pozitës së tij të mire gjeografike të cilën e shfrytëzonte maksimalisht për përfitime ekonomike dhe për shkak të

xhelozisë që provokonin dardanët duke u krenuar me te. Për domethënien e emrit të këtij heroi legjendar janë munduar shumëkush me dhënë sqarime, por të gjithë kanë dështuar sepse nuk e kanë ditur që edhe ky emër ka për bazë fjalën -*Li*. Disa kanë thënë se vjen prej fjalës Ahilos që do me thënë -buzë, disa të tjerë janë munduar ta shpjegojnë me fjalën Aspetos që do me thënë -i shpejtë. Kjo nuk ka lidhje ma asnjërin shpjegim. Domethënia e këtij emri është shumë e thjeshtë, shumë e qartë dhe shumë shqip dhe përbëhet prej fjalëve: *Aq – i – Li* që do me thënë Aq madhështor, aq i hijshëm, aq i bukur. Edhe emri *Dheukalioni* shpjegohet me fjalë shqipe edhe pse shumë shkencëtarë këtë emër e marrin për emër grek gjë që nuk është e vërtetë. Emri Dheukalioni përbëhet prej fjalëve: *Dheu – ka – Li – oni* që do me thënë toka jonë që ka lartësi që është shkëmbore. Do me thane Dheukalioni me Arkë shpëtoi nga përmbytja sepse shkoi në një vend malor ku nuk kishte mundur ta arrije uji.

Sipas mitologjisë Dheukalioni është pandam i Noehit Hebraik. Bile-bile hebrenjtë na e kanë vjedhur këtë të shenjët duke ia ndërruar emrin dhe duke e pagëzuar Noeh. Emri *Olimbi* përbëhet prej fjalëve: -*O* që do me thënë *është*: sepse pellazgët më herët por edhe sot e kësaj dite disa shqiptarë ende kur pyesin për ndokënd a është aty nuk thonë: A është filani aty?! Por: *A O* filani aty ?! dhe fjalës *Li* që e kemi thënë disa here kuptimin e saj dhe fjalës -*mbi* që tregon pozicionin *mbi*. Pra emri *Olimbi* do me thënë është mire, *është madhështi mbi atë mal* sepse është fjala për malin Olimbi ku ishte panteoni i perëndive pellazgjike. Besoj që fjalët që i zbërtheva dhe fjalët që do t'i ofroj në vazhdim dhe të cilat kanë për bazë fjalën -li do të jenë të mjaftueshme për të arsyetuar shpjegimin tim. Ja edhe fjalët e tjera që për bazë kanë fjalën -*Li: Li*-ka-oni, *Li*-gjë, E-*li*-koni, Me-*li*-sa, I-*li*-unë, The-sa-*li*-a, Ak(k=q)ro-po-*Li*, *Li*-bi, *Li*-ban, Ka-*li*-doni, E-*li*-da, E-*li*-ta, *Li*-der, Se-*li*-a, I-*li*-unë, *Li*-gurët, Ti-*lis*, Po-*li*-trion, Ma-*li*-a, U-*li*-ksi, *Li*-rku, *Li*-ndi, *Li*-bri, Ba-*li*, *Li*-dija, Po-*li*-ti-ka, Pe-*li*, Pe-*li*-gonët, Po-*li*-teia, Hop-*li*, Y-*li*-beri, Argo-*li*-da, E-*Li*-a, Sto-*Li*(si dekorim dhe si pozicion), *Li*-duana etj, etj, etj. Nga sa u tha më lartë po shihet shumë qartë që pellazgët e më vonë Ilirët me fjalën-*Li* e cila na paraqitet herë si emër e herë si mbiemër emëronin fëmijët, udhëheqësit, bimët, gjësendet, vendet e nganjëherë edhe kafshët përmes të cilit dëshironin të shprehnin respektin dhe vlerësimin e tyre të lartë ndaj atij njeriu, vendi, gjësendi apo kafshe të cilën e emëronin me këtë mbiemër, i cili siç e thamë edhe më lartë ka kuptimin *shkëmb, i madh, madhështor i hijshëm* e kështu me radhë.

2. PËRFUNDIME

Në bazë të kësaj që u tha më lartë shihet qartë që mbiemri *Li* është fjalë bosht e fjalëformimit të shumë emrave të perëndive dhe hyjnive të ndryshme, njerëzve, të heronjve mitik, të fiseve të ndryshme, të vendeve të ndryshme, të bimëve, të kafshëve e të gjësendeve të ndryshme dhe se ka kuptimin *shkëmb, i madh, i lartë, i hijshëm, madhështor* e kështu me radhë. Në bazë të gjenealogjisë dhe kohës kur paraqitet kjo fjalë shihet qartë që kjo është fjalë shumë e vjetër, bile edhe më e vjetër se vet emri Grek gjë që katërçipërisht dëshmon që nuk është fjalë greke, por është fjalë pellasgjike e cila gjithashtu dëshmon *që gjuha pellasgjike nuk është bijë, por është ëmë e gjuhëve evropiane dhe atyre indoevropiane.* Në gjuhën shqipe ka edhe shumë fjalë tjera që e dëshmojnë këtë konkluzion, por për ato do të flasim në ndonjë rast tjetër.

3. STUDIME MBËSHTETËSE

1. Aristidh Kola: "Arvanitasit dhe prejardhja e Grekëve"
2. Dr. Eqrem Çabej: "Studime Gjuhësore"
3. Mathieu Aref: " Shqipëria odiseja e pabesueshme e një populli parahelen"
4. Robert d'Angely: " Enigma"
5. N. Vlora Falaski: " Pellazgët Ilirët Etruskët Shqiptarët"
6. E. Kocaqi :" Shqipja Çelsi i Gjuhëve Indoeuropiane"
7. Sh. Islamaj: " Gjuha ligjërimi dhe fjala"
8. Dr. A. Spahiu: " Pellazgët dhe Ilirët në Greqinë e vjetër"
9. Louis Benloew: "Greqia përpara Grekëve"
10. Aristidh Kola: " Gjuha e Perëndive"
11. Mathieu Aref: " Mikenët=Pellazgët"